



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Kërkesë për ofertim për furnizim të softverit për platformën digjitale të OSK-së

Oda e Stomatologëve të Kosovës është organizatë profesionale e stomatologëve të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovës.

Me qëllim ndihmës së anëtarëve tanë dhe sofistimin e shërbimeve tona në përputhje me trendet e teknologjisë bashkëkohore, OSK është duke planifikuar zhvillimin e një softveri për menagjimin anëtarëve dhe shërbimeve të saj, që do të përfshijë modulet si anëtarësim, licencim, rilicencim, edukimine vazhdueshëm professional dhe shërbime tjera

Softveri duhet ti mundësojë anëtarëve tanë që shërbimet e lartëcekura të cilat deri më tani janë ofruar në mënyrë fizike, ti realizojnë nëpërmjet qasjes online.

Softveri duhet të përfshijë menaxhimin e anëtarëve, të dhënat e tyre personale, krijimin e mundësisë për ngarkesa të dokumentave në lidhje me realizimin e këtyre shërbimeve. Po ashtu ndër të tjera ky softver duhet të jetë e ndarë në pjesën e anëtarëve dhe pjesën e administratorëve të cilët do të menagjojnë dhe ofrojnë shërbimet e krijuara. Softveri duhet të jetë në gjendje që të gjenerojë të gjitha hapat e domosdoshëm për realizimin e të gjitha fazave të shërbimit deri në nxjerrjen e vendimit final.

Realizimi i platformës digjitale të parashihet në dy faza të zhvillimit të saj.

Krahas ofertës financiare dhe Planin kohor për zhvillimin dhe implementimin e platformës duhet përfshinë paku një (1) propozim të dizajnit dhe strukturës së platformës të paraqitura me ngjyra.si dhe të ofrohet një dokument me përshkrim të detajuar të platformës.

Ofertat të dërgohen në kopje fizike deri me **dt. 29.11.2022 ora 14**, në adresën: Ulpiana, rr. Mark Dizdari (përballë Rrethit të Spitalit), D 7, Hyrja II, nr. 6